

## SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë prej:

<b>Xhezair ZAGANJORI</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Evelina QIRJAKO</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Medi BICI</b>	<b>Anëtar</b>

Mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit të datës 11.02.2016, çështjen administrative që i përket:

**PADITËS:**

**Xhelal Balla**

**E PADITUR :**

**Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit**

**OBJEKTI :**

*Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për të dëmshpërblyer paditësin Xhelal Balla me pagën e 21 muajve, për zgjidhje të kontratës së punës në mënyrë të menjëhershme pa shkaqe të justifikuara (pagën vjetore), për zgjidhje të kontratës pa zbatuar afatin e njoftimit (pagën tre mujore), për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës (pagën dy mujore), shpërblimin për vjetërsi në punë (pagën tre mujore), si dhe shpërblimin për pushimet vjetore të pamarra (pagën një mujore).*

**BAZA LIGJORE:**

*Neenet 143 – 155 të Ligjit Nr. 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i Punës”, neenet 32 e 154 të K.Pr.Civile.*

**Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 706 datë 31.01.2013 ka vendosur:**

*Pranimin pjesërisht të padisë së paditësit Xhelal Balla*

*Detyrimin e palës së paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit t’i paguajë paditësit Xhelal Balla :*

- *dëmshpërblimin për zgjidhjen e menjëhershme të pajustificuar të kontratës së punës të barabartë me pagën e 9 (nëntë) muajve pune.*
- *Shpërblimin për vjetërsi me pagën e 3 muajve,*

*gjithsej 12 paga mujore llogaritur me pagën bruto që ka përfituar ai në momentin e ndërprerjes së marrëdhënies së punës 34,776 lekë.*

*Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.*

**Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. 4257 datë 19.11.2014 ka vendosur:**

*Lëniën në fuqi të vendimit nr. 706 datë 31.01.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.*

Kundër vendimit nr. 4257 datë 19.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, ka ushtruar recurs pala e paditur Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, e cila ka kërkuar ndryshimin e vendimeve dhe rrëzimin e padisë.

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të ligjit 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” i ndryshuar.

### V E N D O S I

**Ndryshimin e vendimit nr. 706 datë 31.01.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe vendimit nr. 4257 datë 19.11.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë dhe rrëzimin e padisë.**

**Tiranë, më 11.02.2016**

**Nr. 31003-00604-00-2015 i Regj. Themeltar  
Nr. 00-2016-1464 i Vendimit (95)**